



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



# Konstatime nga Vëzhgimi i Ditës së Zgjedhjeve & nga Anketimi i Komisionerëve të Qëndrave të Votimit

---

*23 Qershor, 2013 Zgjedhjet Parlamentare në  
Shqipëri*

---

***Shkurtime:***

<b>IFES:</b>	(International Foundation for Electoral Systems)-Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Elektorale
<b>USAID:</b>	(United States Agency for International Development)- Agjencia e SH.B.A për Zhvillim Ndërkombëtar
<b>KQZ:</b>	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
<b>IDRA:</b>	(Institute for Development Research and Alternatives)- Instituti për Zhvillim Kërkimor dhe Alternativa
<b>QV:</b>	Qëndër Votimi
<b>KQV:</b>	Komisioni i Qendrës së Votimit
<b>DKETEZ</b>	Drejtoria e Komisioneve Elektorale, Trajnimeve dhe Edukimit të Zgjedhësve
<b>ZAZ:</b>	Zona e Administrimit Zgjedhor
<b>PV:</b>	Proçesverbal
<b>KZAZ:</b>	Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor

## I. *Vështrim i përgjithshëm i Studimit për Ditën e Zgjedhjeve*

Në muajin Shkurt 2013, IFES, me mbështetjen e USAID-it, inicioi një program të ri për të asistuar me Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë të datës 23 Qershor. Pasi u bë një vlerësim i detajuar i nevojave i cili kërkonte input nga stakeholders të ndryshëm, IFES filloi të ofrojë asistencë teknike në fusha kyçe të administrimit të zgjedhjeve, përfshirë trajnim dhe mbështetje për stafin e 5,508 Qëndrave të Votimit (QV-ve). IFES bëri një analizë të strategjisë së trajnimit të Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve (DKZTEZ) dhe ofroi disa rekomandime për zgjedhjet aktuale si dhe ato të ardhshme. Duke u fokusuar tek nevojat që Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) i shihte si më kritiket, IFES mori përsipër të bente të mundur Trajnimin e Trajnerëve të KQZ-së të cilët do të trajnonin pothuaj 40,000 komisionerë të QV-ve në gjithë vendin.

Pjesë e këtij procesi ishte dhe prodhimi i një manuali për trajnerët e KQZ-së, i pari e këtij lloji. IFES gjithashtu bëri një vlerësim “live” të Ditës së Zgjedhjeve, të përgatitjes së anëtarëve të Komisioneve të Qëndrave të Votimit (KQV) dhe aftësive të tyre për të kryer detyrën.

Ky raport paraqet konstatime nga vlerësimi i Ditës së Zgjedhjeve kryer nga IFES. Në javët pas zgjedhjeve, IFES gjithashtu organizoi disa Grupe të Fokusuara me përfaqësues nga KQV të zonave të ndryshme të vendit, ku u eksploruan më në detaje disa nga konstatimet e vlerësimit të Ditës së Zgjedhjeve. Aty ku duket e arsyeshme, IFES i është referuar Grupeve të Fokusuara në këtë raport, dhe do të botojë një raport të veçantë i cili do të japë një pamje të detajuar të punës me grupet e fokusuara si dhe konstatimet.

Për Vlerësimin e Ditës së Zgjedhjeve u përdor një listë kontrolli (checklist) për të vlerësuar përgatitjen e qendrave të votimit dhe një pyetësor i shkurtër për anëtarët e KQV-ve. IFES kontrakttoi Institutin Kërkimor të Zhvillimit dhe Alternativave (IDRA), një organizatë që operon në Tiranë, për të kryer punën në terren. Nga 5,508 qendra votimi në total, projekti pozicionoi intervistuesit në 512 qendra votimi, të shpërndara në mënyrë proporcionale në 89 Zona të Administrimit Zgjedhor dhe të ndara në mënyrë proporcionale ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Nga shtatë anëtarë të qendrës së votimit, për çdo qendër votimi u përzgjedh në mënyrë rastësore një anëtar për t’u intervistuar. Detaje të tjera të metodologjisë që u përdor për anketimin janë:

- 52% e qendrave të votimit të vizituara ishin në zona urbane dhe 48% ishin në zona rurale.
- Koha mesatare që intervistuesit kaluan në qendrën e votimit ishte 26 minuta.
- 71% e intervistave u zhvillua në mëngjes (Nga ora 07:00 që ishte dhe ora e hapjes deri në orën 12:59) dhe 29% e intervistave u zhvillua mbasdite (Nga ora 13:00 deri në orën 19:00 që ishte dhe ora e mbylljes).
- Marzhi i gabimit për këtë kampion është + ose - 4.33%
- Shtrirja e intervistave të kryera sipas një klasifikimi më të gjërë rajonal është si më poshtë:
  - **Zona Bregdetare** (Lezhë, Kurbin, Kavajë, Mallakastër, Lushnjë, Delvinë, Sarandë, Durrës, Fier, Vlorë): 32%
  - **Zona Qëndrore** (Kuçovë, Skrapar, Krujë, Peqin, Gjirokastër, Përmet, Tepelenë, Tiranë – zona rurale, Shkodër, Elbasan, Devoll, Kolonjë, Pogradec, Mirditë, Pukë, Malësi e Madhe, Mat, Berat, Korçë): 35%

- **Zona Malore** (Kukës, Has, Tropojë, Bulqizë, Dibër, Gramsh, Librazhd): 11%
- **Tiranë**: 22%

### Detaje për Grupet e Fokusuara

IFES gjithashtu kontrakttoi IDRA-n për të organizuar diskutimet e grupeve të fokusuara me anëtarët e KQV-ve në javët në vijim pas Ditës së Zgjedhjeve. Dy grupe të fokusuara u organizuan në secilin nga këto qytete: Tiranë, Korçë, Fier, dhe Shkodër. U bë përpjekje që të kishte një lloj balance midis përkatësisë partiake, pozicionit brenda KQV, gjinisë, zonës gjeografike (urbane/rurale), dhe nivelit të eksperiencës me zgjedhjet e kaluara. Duke u përpjekur të kishte një balancë të partive të ndryshme politike të përfaqësuara në KQV, fatkeqësisht IFES mundi të siguronte vetëm kontaktet për komisionerët e dy partive më të mëdha. Megjithatë, duke patur parasysh mënyrën e përbërjes së KQV-së, pjesëmarrësit e përzgjedhur ishin përfaqësues të shumicës së anëtarëve të KQV-ve.<sup>1</sup> Disa nga konstatimet e nxjerra nga grupet e fokusuara që plotësojnë përgjigjet për pyetjet e sondazhit do të prezantohen në këtë raport.

Profili i Pjesëmarrësve të Grupeve të Fokusuara											
	Gjinia		Pozicioni në KQV			Partia e Përfaqësuar		Eksperienca me zgjedhjet e mëparshme			
	Femra	Meshkuj	Kryetar	Sekretar	Anëtar	PD	PS	Një	Dy	Tre	Më shumë se 3
Tiranë I	3	1	1	3	0	0	4	0	2	0	2
Tiranë II	1	8	6	3	0	5	4	3	2	4	0
Fier I	3	6	2	5	2	4	5	2	2	0	5
Fier II	5	6	3	7	1	2	9	0	0	3	8
Shkodër I	2	6	5	2	1	4	4	0	0	4	4
Shkodër II	2	3	2	3	0	3	2	2	1	1	1
Korçë I	3	5	5	2	1	5	3	2	1	2	3
Korçë II	3	4	3	3	1	3	4	0	1	2	4
<b>Totali</b>	<b>22</b>	<b>39</b>	<b>27</b>	<b>28</b>	<b>6</b>	<b>26</b>	<b>35</b>	<b>9</b>	<b>9</b>	<b>16</b>	<b>27</b>

## II. Përmbledhja Kryesore & Rekomandime

Konstatimet nga vëzhgimi dhe anketimi i bërë me anëtarët e KQV-së theksojnë aspektet pozitive të Ditës së Zgjedhjeve si dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim. Materialet për Edukimin e Zgjedhësve ishin vendosur sipas Kodit Zgjedhor të Shqipërisë në shumicën e qendrave të votimit (93%) dhe u vu re që

<sup>1</sup> KQV-të përbëhen nga shtatë anëtarë. Dy anëtarë propozohen nga partia më e madhe e shumicës parlamentare, dy nga partia më e madhe e opozitës parlamentare, një anëtar nga partia e dytë më e madhe e shumicës parlamentare, një anëtar nga partia e dytë më e madhe e opozitës parlamentare. Në gjysmën e KQV-ve anëtari i shtatë propozohet nga partia më e madhe e shumicës parlamentare, ndërsa në gjysmën tjetër ky anëtar propozohet nga partia më e madhe e opozitës parlamentare. (Neni 36)

ishin ekspozuar mjaft mirë me qëllim që zgjedhësit të mund t'i shihnin. Qëndrat e Votimit gjithashtu u panë të funksiononin me lehtësi në lidhje me menaxhimin e fluksit të zgjedhësve. Ndërsa në disa kishte rradhë të gjata, në pjesën më të madhe të tyre kishte rregull. Shumica e procedurave të kërkuara për marrjen me zgjedhësin u zbatuan, por rrallë ndodhnin plotësisht në rendin e duhur (vetëm në 6% të rasteve të vëzhguara). Pavarësisht faktit që kjo çështje u mbulua në manualin e trajnimit, duket sikur rendi i procedurave nuk ishte një gjë plotësisht e qartë për anëtarët e KQV-ve. Të dhënat gjithashtu tregojnë për nevojën për të përmirësuar aksesin në qëndrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara: pak qëndra votimi dukeshin të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara (18%).

Konstatimet nga grupet e fokusuara zbuluan fusha të tjera me interes. Edhe pse përafërsisht gjysma e komisionerëve u emëruan më vonë se tre javë para zgjedhjeve (48%), shumë pjesëmarrës të grupeve të fokusuara nuk e shohin këtë praktikë si problematike. Ata theksuan që gjithë komisionerët potencialë janë njoftuar rreth një muaj para dhe shumica janë trajnuar, më pas lista përfundimtare e anëtarëve të KQV-ve plotësohet afër ditës së zgjedhjeve. Shumë besojnë që kjo praktikë ndiqet me qëllim që të minimizohet rreziku që një i emëruar nga partia të korruptohet apo të mos i qëndrojë besnik partisë ndërsa dita e zgjedhjeve afrohet.

Shumica e anëtarëve të KQV-ve që u intervistuan kishin marrë një lloj trajnimi para Ditës së Zgjedhjeve (95%), por 5% nuk kishin marrë asnjë lloj trajnimi. Gjashtëdhjetë e gjashtë përqind raportuan që kishin marrë trajnim nga KQZ/një trajner i KQZ-së, ndërsa 34% nuk kishin marrë ndonjë trajnim nga KQZ. Dyzet e dy përqind kishin marrë trajnim nga një anëtar tjetër i KQV-së/Kryetari, ndërsa 2% thanë që një entitet tjetër ju ofroi trajnimin. Të pyeturit në masë dërrmuese e vlerësuan trajnimin si shumë të dobishëm: 83% e atyre që ishin trajnuar nga një anëtar tjetër i KQV-së; 84% e atyre që ishin trajnuar nga KQZ; dhe 86% e atyre që ishin trajnuar nga një parti politike.

Konstatimet nga Grupet e Fokusuara na japin perceptime të tjera mbi cilësinë e trajnimeve. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve besojnë që trajnimet nga partitë ishin shumë praktike në lidhje me administrimin e procesit të votimit, ndërsa trajnimi i dhënë nga KQZ ishte më shumë i fokusuar në ligjin zgjedhor dhe në teorinë e praktikave të kërkuara. Ndërsa shumica e pjesëmarrësve ishin të kënaqur me cilësinë e trajnimeve si nga partia edhe nga KQZ-ja, disa ofruan rekomandime për përmirësime, si për shembull: të ketë më pak njerëz që trajnohen në çdo sesion trajnimi, trajneri të mos lexojë thjesht manualin, të jepen shembuj praktikë/të improvizohen skenarë të ndryshëm dhe trajnimet të jenë më të gjata.

Shumica e komisionerëve gjithashtu e kishin marrë manualin e trajnimit dhe thanë që manuali ishte *shumë* i dobishëm (85%) ose *deri diku* i dobishëm (15%). Gjithashtu shumica e komisionerëve ndjeheshin *shumë* të përgatitur (81%) për të punuar si komisionerë të qëndrave të votimit, ndërsa 19% ndjeheshin *deri diku* të përgatitur. Ata që punonin për herë të parë me zgjedhjet ishin më të predispozuar të raportonin që ndjeheshin vetëm *deri diku* të përgatitur (29%) krahasuar me ata që kishin më shumë eksperiencë me zgjedhjet (14%). Në vijim, anëtarët e KQV-ve ishin më të predispozuar të raportonin që ndjeheshin vetëm *deri diku* të përgatitur (23%) krahasuar me Kryetarët dhe Sekretarët e KQV-ve (12%).

Komisionerët do të dëshironin të kishin më shumë informacion për disa procedura si gjetja e emrave të votuesve në listë (31%); plotësimi i procesverbalit të mbylljes (26%); menaxhimi i ankesave të zgjedhësve/vëzhguesve (19%); hapja e qendrës së votimit (18%); dhe mbyllja e materialeve (13%). Kur ju janë prezantuar ide për materiale të mundshme trajnimi që ata mund të kenë në dispozicion përpara zgjedhjeve të ardhshme, 67% ju pëlqeu ideja e një video trajnimi, dhe 43% do ju pëlqente një udhëzues me referenca apo një listë me detyrat që duhen kryer nga anëtarët e KQV-ve. Pjesëmarrësit e Grupeve të Fokusuara përsëritën që një video, përveç trajnimit dhe manualit do të ishte e dobishme për shumë anëtarë të KQV-ve. Megjithatë ata theksuan që kjo nuk duhet të zëvendësojë trajnimin apo manualin dhe duhet të përdoret për të plotësuar aktivitetet e trajnimit. Ata gjithashtu mendonin që do të ishte më mirë që video e trajnimit të ishte në një DVD sesa online, për arsye të lidhjes jo të sigurt të internetit në shumë zona.


### III. Konstatime—Lista e Kontrollit e Vëzhgimit për Përgatitjen e Qendrës së Votimit

#### Ekspozimi i Materialeve për Edukimin e Zgjedhësve

Edukimi si Zgjedhës për qytetarët është një përgjegjësi e rëndësishme e shtetit, dhe në shumë raste kjo përgjegjësi i takon organit të administrimit të zgjedhjeve. Në Shqipëri, KQZ ka përgjegjësinë për marrjen e masave dhe organizimin e programeve të edukimit për qytetarët. (Neni 21 i Kodit Zgjedhor). Në praktikë, KQZ shpërndan materialet për edukimin e zgjedhësve si pjesë të paketave për komisionet në zonat zgjedhore (KZAZ), të cilat më pas shpërndahen nëpër Qëndrat e Votimit disa ditë para zgjedhjeve. Për zgjedhjet Parlamentare 2013, këto materiale përbëheshin nga një poster edukativ dhe një poster me natyrë informative i cili i informonte zgjedhësit sesi të votonin, çfarë dokumentash identifikimi duhet të paraqitnin, cila ishte koha e hapjes dhe e mbylljes së QV-ve, si dhe fletëpalosjet në gjuhët e minoriteteve. KQZ gjithashtu përgatiti spote radio-televizive informative për publikun të cilat mbulonin çështje të tilla si: si të votohet, kush mund të votojë, ora e hapjes së QV-së. Këto materiale gjithashtu i inkurajonin njerëzit-veçanërisht ata që votonin për herë të parë-të shkonin të votonin, duke i nxitur zgjedhësit të bënin zgjedhjet e tyre dhe të shmangnin votimin familjar ndërsa i kujtonin ata që kjo e dyta është krim, dhe gjithashtu i tregonin se çfarë duhej bërë para zgjedhjeve nëse emri yt nuk ishte në listën e zgjedhësve.<sup>2</sup>

Në tërësi vlerësimi evidentoj që materialet për edukimin e zgjedhësve ishin paraqitur të paktën relativisht mirë në shumicën e qendrave të votimit.

- Nëntëdhjetë e tre përqind e qendrave të votimit të vëzhguara kishin materiale zyrtare të edukimit të zgjedhësve për procedurat e votimit, si për shembull si të votosh dhe si të shënosh fletën e votimit, të ekspozuara brenda apo jashtë qendrës së votimit, ndërsa 7% nuk kishin.
- Lidhur me vendin se ku ishin vendosur këto materiale, ato dukeshin të ishin ekspozuar shumë mirë (66%), e përcaktuar



kjo në Kodin Zgjedhor si jashtë qendrës së votimit ose në qendrën e votimit ku edhe zgjedhësi ka kohë që të lexojë para se të votojë. Në 27% të rasteve ishin ekspozuar deri diku mirë, të përcaktuara si disa nga materialet mund të lexoheshin dhe kuptoheshin nga zgjedhësit para sesa

<sup>2</sup>Materialet e KQZ-së mbi Edukimin e Zgjedhësve mund te gjenden në:

[http://www.cec.org.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=372%3Aspote-tvradio&catid=132%3Afushata-edukuese-dhe-sensibilizuese&Itemid=325&lang=en](http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=372%3Aspote-tvradio&catid=132%3Afushata-edukuese-dhe-sensibilizuese&Itemid=325&lang=en)

*ata të merrnin fletën e votimit, ndërsa në 7% ishin ekspozuar dobët, përcaktuar si të vendosura në një sipërfaqe apo mënyrë që zgjedhësve ju shërben shumë pak ose aspak për t'u informuar përpara se të votojnë.*

### **Rregulli në ambientet e brendshme të Qëndrave të Votimit**

*Sipas Kodit Zgjedhor, Qëndrat e Votimit nuk duhet të kenë më shumë se 1000 zgjedhës. Në Tiranë, ky numër u ul në 700 votues, për shkak të një teknologjie pilot që ishte planifikuar të përdorej për numërimin automatik. Ndërsa këto shifra nuk përfaqësojnë një qëndër votimi tepër të madhe, nevoja për të gjetur 5,508 vende për qëndrat e votimit në Shqipëri, disa prej tyre të reja për shkak të rritjes së numrit të Qëndrave të Votimit këtë vit, bëri që administrata e qeverisë lokale të përzgjidhte ambiente që në disa raste nuk ishin ideale. Një shqetësim para zgjedhjeve ishte që nëse kjo çështje nuk do të menaxhohej si duhet, përdorimi i ambienteve jo të mira si Qendra Votimi do të krijonte rradhë të gjata të zgjedhësve, dhe gjithashtu do të ç'organizonte votimin. Prezenca e policisë në ose rreth e rrotull Qëndrave të Votimit ishte një çështje tjetër shqetësuese, qoftë për drejtimin e punës së komisioneve apo frikësimin e zgjedhësve.<sup>3</sup>*

*Nga konstatimet e vlerësimit të ditës së zgjedhjeve, këto frikëra duken që janë konkretizuar deri diku dhe kishte pak raste të tilla pasi shumica e qëndrave u vlerësuan si të rregullta. Ndërsa në mbi një të tretën e KQV-ve kishte rradhë të gjata, pjesa më e madhe e tyre u vlerësuan si të rregullta. Punonjës të Policisë u panë vetëm në pak QV dhe asnjëherë nuk u gjetën në ambientet e brendshme. Në disa raste, megjithatë, njerëz që nuk ishin komisionerë të QV-ve (ilegalisht) drejtonin zgjedhësit.*

- **Rradhët dhe Menaxhimi i radhëve:** Në 57% të qëndrave të votimit nuk kishte rradhë të gjata dhe qëndrat e votimit u vlerësuan si të rregullta dhe nuk kishte grumbullime njerëzish brenda, dhe në 24% të qëndrave të votimit u vunë re rradhë të gjata, por qëndrat u vlerësuan si të rregullta dhe pa grumbullime. Në disa raste të tjera u raportuan grumbullime dhe rradhë të gjata: në 5% të tyre nuk kishte rradhë të gjata por kishte shumë zgjedhës brenda qëndrës së votimit dhe në 13% të qëndrave të votimit kishte rradhë të gjata dhe parregullsi.
- **Punonjësit e Policisë:** Në 93% të qëndrave të votimit të vëzhguara, nuk kishte punonjës të policisë, ndërsa në 7% të qëndrave të votimit punonjësit e policisë ishin brenda 150 metrave nga QV-ja, por jo brenda QV-ve.
- **Punonjës jo të Duhur që drejtonin Zgjedhësit:** Në 5% të qëndrave të votimit kishte njerëz të tjerë përveç komisionerëve të KQV-ve që në një farë mënyre drejtonin zgjedhësit brenda qëndrës së votimit: ose persona që e bënin këtë gjithë kohës (2.5%) ose herë pas herë (2.5%).

<sup>3</sup>Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në ambientet e Qendrës së Votimit. (Neni 110). Policia e shtetit lejohet brenda Qendrës së votimit vetëm për të rivendosur rendin, me kërkesë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe duhet të largohet sapo rendi është rivendosur. (Neni 109).



### Zhvillimi dhe Radha e Proçedurave të Votimit

Procedurat e votimit nuk janë shumë komplekse në Shqipëri, megjithatë hapat që duhen ndjekur, dhe rradha e tyre, mund të bëhen të vështira nëse nuk i jepet secilës koha dhe rëndësia e duhur.

Intervistuesve ju dha një listë me pesë hapa kryesore për t'i vëzhguar, pa u instruktuar paraprakisht se cili duhet të ishte rendi i duhur<sup>4</sup>. Si fillim *kontrolli i gishtit a ishte i lyer me bojë* dukej të ishte proçedura më problematike lidhur marrjen me zgjedhësin, gjë që ndodhte në më pak se gjysmën e gjithë vëzhgimeve. Hapa të tjera të rëndësishme të proçedurave të votimit u kryen rregullisht si më poshtë:

- Zgjedhësit i kontrollohet gishti nëse është me bojë: 49%
  - Zgjedhësit i kërkohet të firmosë pranë emrit: 99%
  - Zgjedhësit i kërkohet dokument identifikimi: 99%
  - Zgjedhësit i jepet fleta e votimit: 99%
  - Zgjedhësit i bëhet gishti me bojë nga komisioneri: 97%
- 
- Të pesë proçedurat së bashku u zbatuan në 48% të vëzhgimeve ndërsa katër nga pesë proçedura u zbatuan në 47% të vëzhgimeve. Në 4% të vëzhgimeve vetëm tre nga pesë proçedura u zbatuan.
  
  - Radha e hapave që duheshin kryer me zgjedhësin ose nuk ishte e njohur nga anëtarët e KQV-ve, ose thjesht nuk zbatohet në mënyrë shumë strikte. Vetëm në 6% të vëzhgimeve të pesë proçedurat ndodhën plotësisht në rendin e duhur, ndërsa në 94% të rasteve jo.
    - Në 78% të rasteve, anëtarët e KQV-ve e dinin që duhet të kërkonin për mjetin e identifikimit, por pjesa tjetër e proçedurave nuk u kryen në rregull.

---


<sup>4</sup> Radha korrekte e pesë hapave është: 1) Zgjedhësit i kërkohet mjeti i identifikimit 2) Zgjedhësit i kontrollohen gishtat për bojën 3) Zgjedhësit i kërkohet të firmosë pranë emrit 4) Gishti i Zgjedhësit shënohet me bojë 5) Zgjedhësit i jepet fleta e votimit

### Aksesi i Qëndrave të Votimit për Personat me Aftësi të Kufizuar

Sipas Kodit Zgjedhor, zgjedhësit kanë të drejtën t'i kërkojnë administratës lokale t'i regjistrojë ata si zgjedhës të cilët kanë nevojë për kushte të veçanta për të votuar (Neni 108). KQZ, mbështetur në informacionin e marrë nga administrata e qeverisë vendore, normalisht siguron fletë votimi të posaçme për të verbërit (me shkrimin Braille) si dhe përmirësimet në infrastrukturë si për shembull rampat për njerëzit me karrige me rrota. Është pozitive që KQZ nxori një udhëzim për njësitë e administrimit lokal që të gjitha qëndrat e votimit të jenë në katet e para dhe që të merreshin masa për ta bërë më të lehtë procesin e votimit për personat me aftësi të kufizuar. Përpara zgjedhjeve, KQZ gjithashtu ka firmosur një marrëveshje bashkëpunimi me grupet me aftësi të kufizuar për të bërë më të aksesueshëm ambientet ku do të votohej.<sup>5</sup> Vec të tjerash KQZ ra dakord që qëndrat e votimit të ishin në katin e parë dhe të vendoseshin rampat në vendet ku ka zgjedhës me aftësi të kufizuar. Edhe komuniteti ndërkombëtar ka bërë përpjekje për të ndihmuar KQZ të krijonte lehtësira për zgjedhësit e verbër; megjithatë, për arsye teknike KQZ nuk mundi ta realizonte këtë objektivë.

Të dhënat nga vëzhgimi i Ditës së Zgjedhjeve nxjerrin në pah një nevojë domethënëse për përmirësim në aksesin e qëndrave të votimit për personat me aftësi të kufizuar.

- Pak qendra votimi (18%) u vlerësuan si të aksesueshme që një person në karrige me rrota mund të hynte pa ndihmë.



<sup>5</sup>Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar, 21 Mars 2013  
[http://www.cec.org.al/images/stories/vep\\_njoftime/zgjidh\\_aftesi\\_kufizuar/marrveshje\\_kkpak.pdf](http://www.cec.org.al/images/stories/vep_njoftime/zgjidh_aftesi_kufizuar/marrveshje_kkpak.pdf), parë për herë të fundit në 20 Gusht 2013

- Kur shihen çështje me specifike lidhur me aksesin për njerëzit me aftësi të kufizuar, të dhënat tregojnë një pamje me më shumë nuanca. Sipas vëzhgimeve, 85% e QV-ve ishin vendosur në katet e para, deri diku në pajtueshmëri me objektivin e deklaruar nga KQZ. Megjithatë, duhet theksuar që në një të katërtën (26%) e të gjitha qëndrave të votimit duheshin ngjitur të paktën 8 shkallë dhe 37% e QV-ve ishin vendosur më larg se 30 metra nga hyrja e ndërtesës ku ndodheshin qëndrat e votimit. Gjithashtu, ndërsa 69% e qëndrave të votimit ishin vendosur në një mënyrë të tillë që një zgjedhës në karrige me rrota mund të manovronte me lehtësi brenda qendrës së votimit, në 31% nuk ishte kështu.

Vëzhgime për Çështjen e Aksesit në QV	% PO
Çështje e aksesit për personat me aftësi të kufizuar fizike: Qendra Votimi të vendosura në katet e para	85% po
Çështje e aksesit për personat me aftësi të kufizuar fizike: Distanca nga hyrja e ndërtesës deri në qendrën e votimit (më shumë se 30 metra)	37% po
Çështje e aksesit për personat me aftësi të kufizuar fizike: Më shumë se shtatë shkallë për të hyrë në qendrën e votimit	26% po
A ishte qendra e votimit nga brenda e organizuar në një mënyrë të tillë që një zgjedhës në karrige me rrota mund të manovronte me lehtësi brenda QV-së?	69% po

#### IV. Konstatime—Anketimi për anëtarët e KQV-ve


Pasi hynin në qendrën e votimit, intervistuesit në mënyrë rastësore përzgjidhnin një nga shtatë anëtarët e QV-së për ta intervistuar. Ata që përzgjidheshin informoheshin që intervistuesi ishte një vëzhgues i IFES dhe që IFES është një organizatë që po punon me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve në Shqipëri. Pyetësori përbëhej nga 12 pyetje dhe të intervistuarit siguroheshin që përgjigjet e tyre do të mbeteshin anonime. Në javët pas zgjedhjeve u organizuan gjithashtu Grupe të Fokusuara me anëtarë të tjerë nga KQV-të.<sup>6</sup> Disa nga konstatimet që dolën nga grupet e fokusuara do të paraqiten në këtë raport për të plotësuar të dhënat nga anketimi.

##### Profili i të Intervistuarve

- **Gjinia:** 81% e komisionerëve të intervistuar ishin meshkuj dhe 19% ishin femra.<sup>7</sup>
- **Pozicioni në KQV:** 66% e të intervistuarve ishin anëtarë të KQV-ve, 17% ishin Kryetarë dhe 18% ishin Sekretarë.
- **Eksperienca me Zgjedhjet:** Ka një ndarje interesante përsa i përket eksperiencës së anëtarëve të KQV-ve. Shumica e anëtarëve të KQV-ve (68%) kanë punuar në zgjedhje të mëparshme, ndërsa një e treta e komisionerëve raportuan që këto ishin zgjedhjet e para për ta (32%).

<sup>6</sup> Nuk kishte ndonjë lidhje ndërmjet përzgjedhjes së anëtarëve të KQV-ve për t'u intervistuar në Ditën e Zgjedhjeve dhe atyre të përzgjedhur me vonë për grupet e fokusuara.

<sup>7</sup> Aktualisht nuk ka ndonjë detyrim ligjor për gjininë në përbërjen e KQV-ve (ndërkohë që ka një detyrim të tillë për komisionet e nivelit zonal). Në kohën e publikimit të këtij raporti IFES-i po bënte përpjekje për të siguruar të dhënat gjinore për përbërjen e KQV-ve.




- Koha e Emërimit:** Sipas Kodit Zgjedhor, anëtarët e KQV-ve duhet të caktohen jo më vonë se 25 ditë para Ditës së Zgjedhjeve, nëse kandidatët e propozuar përbushin detyrimet ligjore; megjithatë, anëtarët e KQV-ve nuk duhet të caktohen më vonë se 20 ditë para Ditës së Zgjedhjeve (Neni 36). Nga përgjigjet e të intervistuarve, shumica (64%) e komisionerëve ishin emëruar më vonë se tre javë para zgjedhjeve (48%) apo ekzaktësisht tre javë përpara zgjedhjeve (16%). Një e treta (36%) ishin emëruar më herët sesa tre javë përpara zgjedhjeve dhe nuk kishte ndonjë ndryshim të madh se kur një komisioner ishte caktuar nga niveli i tij në KQV. Gjatë grupeve të fokusuara, anëtarët e KQV-ve theksuan se koha e emërimit normalisht nuk përbente problem, dhe në fakt partitë shpesh përzgjedhin dhe trajnojnë grupe të mëdha për vendet vakante në këto komisione, dhe i emërojnë ata formalisht kur afron data e zgjedhjeve. Sipas pjesëmarrësve të grupeve të fokusuara, një arsye e mundshme për këtë është frika se mos të emëruarit mund të korruptohen në favor të interesave të partive opozitare. Gjithashtu është për t'u theksuar që ndërsa preferohet që komisionerët të emërohen sa më herët që të jetë e mundur përpara zgjedhjeve, trajnimet fillonin vetëm brenda dy javëve përpara zgjedhjeve.

### **Trajnimet**

*Nëpërmjet ekipit të trajnerëve, KQZ ofron trajnime për çdo anëtar të çdo KQV-je, zakonisht duke i bashkuar në grupe të vogla disa KQV për një trajnim njëditor. Një shqetësim i madh i DKZTEZ ishte-që për shkak të zëvendësimeve të shpeshta deri në momentin e fundit të anëtarëve të KQV-ve-shumë anëtarë të KQV-ve nuk e kishin marrë trajnimin zyrtar nga KQZ-ja.*

- Ndonëse gati 95% e të intervistuarve kishin marrë një lloj trajnimi para Ditës së Zgjedhjeve kur u pyetën se cili e ofroi trajnimin, duke i lejuar ata të rendisnin më shumë se një nëse ishin trajnuar nga disa entitete, vetëm dy të tretat (66%) raportuan që kishin marrë trajnim nga KQZ/një trajner i KQZ-së, ndërsa 34% nuk kishin marrë trajnim nga KQZ/një trajner i KQZ-së. Dy


të tretat e të intervistuarve (65%) gjithashtu kishin marrë trajnim nga një parti politike, 42% nga një anëtar tjetër i KQV-së/Kryetari, dhe 2% thanë që një tjetër entitet ua kishte bërë trajnimin.



- Në total, 40% e komisionerëve ishin trajnuar vetëm nga një entitet, ndërsa 36% ishin trajnuar nga dy entitete, 18% ishin trajnuar nga tre entitete, më pak se 1% ishin trajnuar nga katër entitete, dhe 5% nuk ishin trajnuar.
- Sipas programit të KQZ-së, trajnimet e anëtarëve të KQV-ve ishin menduar të zgjasnin për një ditë nga ora 10:00-16:00. Nga ata që kishin marrë trajnim nga KQZ/një trajner i KQZ-së, 48% të trajnimeve ishin mbajtur për një ditë të plotë, 30% e trajnimeve kishin zgjatur gjysëm ditë, dhe 22% kishin marrë pjesë në trajnime që kishin zgjatur më pak se gjysëm dite. Një shumicë e konsiderueshme (83-86%) raportoi që trajnimet ishin të dobishme, pavarësisht se cili e ofronte trajnimin.

Cili e ofroi trajnimin në përqindje	Kohëzgjatja e Trajnimit	Dobishmëria e Trajnimit
<b>Një anëtar tjetër i KQV-së/Kryetari (42%)</b>	Ditë e plotë (42%) Gjysëm dite (27%) Më pak se gjysëm dite (31%)	<b>Shumë i dobishëm (83%)</b> Deri diku i dobishëm (16%) Jo shumë i dobishëm (më pak se 1%) Aspak i dobishëm (0%)
<b>KQZ [Trajneri i KQZ-së] (66%)</b>	Ditë e plotë (48%) Gjysëm dite (30%) Më pak se gjysëm dite (22%)	<b>Shumë i dobishëm (84%)</b> Deri diku i dobishëm (15%) Jo shumë i dobishëm (0%) Aspak i dobishëm (më pak se 1%)
<b>Parti Politike (65%)</b>	Ditë e plotë (45%) Gjysëm dite (24%) Më pak se gjysëm dite (31%)	<b>Shumë i dobishëm (86%)</b> Deri diku i dobishëm (13%) Jo shumë i dobishëm (më pak se 1%) Aspak i dobishëm (0%)

- Sipas pyetësorit, shumica e komisionerëve ndiheshin *shumë* të përgatitur (81%) për të punuar si punonjës të qendrave të votimit, ndërsa 19% ndiheshin *deri diku* të përgatitur. Përafërsisht një e treta e atyre që ishin për herë të parë ishin më të predispozuar të raportonin që ndiheshin vetëm *deri diku* të përgatitur (29%), krahasuar me ata me më shumë eksperiencë me zgjedhjet (14%). Anëtarët e KQV-ve ishin më të predispozuar të raportonin që ndiheshin *deri diku* të përgatitur (23%) sesa Kryetarët e KQV-ve (10%) ose Sekretarët (13%).



- Kur u pyetën në Ditën e Zgjedhjeve, një e pesta e gjithë anëtarëve të KQV-ve (20%) mendonin që kishin nevojë për më shumë trajnim, ndërsa 3% mendonin që kishin marrë trajnim mjaftueshëm. Tre çerek (76%) e anëtarëve të KQV-ve mendonin që kishin nevojë për *më pak* trajnim. Ndërsa këto shifra mund të ishin për shkak të numrit të komisionerëve të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme (32%) ose kanë katër apo më shumë experienca si komisionerë me zgjedhjet (43%), kishte pak diferencë midis përgjigjeve të të intervistuarve për këtë pyetje, pavarësisht nëse kishin shumë apo pak eksperiencë me zgjedhjet.
- Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara, megjithatë, shprehën qartë dëshirën për më shumë trajnim, sidomos ata me më pak eksperiencë me zgjedhjet. Për më tepër, shumë nga pjesëmarrësit thanë që atyre do ju pëlqente një strukturë trajnimi me më shumë shembuj praktikë dhe skenarë se çfarë të bënin nëse "X" gjë ndodh. Pjesëmarrësit mendonin që ndërsa teoria dhe baza ligjore e procedurave zgjedhore është e rëndësishme të njihet, ata gjithashtu duhet të jenë të përgatitur se si të reagojnë ndaj disa skenarëve të mundshëm. Po ashtu, disa pjesëmarrës të grupeve të fokusuara shprehën dëshirën për të praktikuar disa nga përgjegjësitë duke përdorur kampionë të materialeve të vërteta zgjedhore, me qëllim që të mos i shohin materialet zgjedhore për herë të parë vetëm Ditën e Zgjedhjeve.

### **Marrja e Materialeve të Trajnimit**

*Para Ditës së Zgjedhjeve, KQZ u shpërndan materialet e trajnimit dhe të edukimit KQV-ve, nëpërmjet komisioneve zonale zgjedhore. Këto materiale përbëhen nga një kopje e Kodit Zgjedhor për çdo anëtar të KQV-së dhe një manual trajnimi, një bllok shënimesh, fletë të bardha dhe stilolapsa për anëtarët e KQV-ve të cilët nuk kanë marrë pjesë në trajnimin për KQV-të. Kryetarët dhe Sekretarët e QV-ve të cilët nuk kanë marrë pjesë në trajnim gjithashtu kanë marrë një dokument me udhëzime për organizimin dhe*

*funksionimin e Qendrës së Votimit. Për shkak të rëmërimeve të shpeshta të anëtarëve të KQV-ve nga partitë politike, egzistonte mundësia që ata anëtarë që emëroheshin pasi ju ishin shpërndarë materialet komisioneve nuk do ta merrnin kopjen e manualit apo kodin apo të dyja. Ky shqetësim rezultoi të ishte i kotë dhe nuk ndodhi kështu:*

- Një shumicë komisionerësh (87%) raportuan që e kishin marrë Kodin Zgjedhor ndërsa përgatiteshin për rolin e tyre si komisionerë.
- Pothuaj të gjithë (95%) e komisionerëve gjithashtu morrën edhe manualin e KQV-së.
  - Pothuaj të gjithë komisionerët që morrën manualin e KQV-së thanë që e kanë lexuar (97%).
  - Një shumicë (85%) e atyre që morrën manualin thanë që ishte *shumë* i dobishëm, ndërsa 15% thanë që ishte *deri diku* i dobishëm. Kishte shumë pak ndryshim në përgjigjet e komisionerëve pavarësisht pozicionit që ata kishin në KQV (kryetar, sekretar apo anëtar) dhe pavarësisht nivelit të ndryshëm të eksperiencës që ata kishin me zgjedhjet.
  - Nga konstatimet nga Grupet e Fokusuara u ritheksua vlerësimi pozitiv i manualit të trajnimit. Anëtarët e KQV-ve raportuan që ishte një udhëzues shumë i mirë për ta gjatë gjithë Ditës së Zgjedhjeve. Megjithatë, po ashtu si për trajnimet, u sygjera që më shumë shembuj praktikë të përfshiheshin në manual-përfshirë dhe skenarë se çfarë veprime duhej të ndërmerreshin nëse “X” gjë ndodhte. Kjo gjë u përmend specifikisht lidhur me problemet që një KQV mund të hasë në Ditën e Zgjedhjeve.

### **Materiale dhe Informacione Shtesë të Nevojshme për Zgjedhjet e Ardhshme**

*Përveç kopjeve të Kodit Zgjedhor dhe një manuali trajnimi, IFES i ka theksuar KQZ-së që të eksplorojë me guida dhe materiale udhëzuese shtesë, për KQV-të dhe komisionet e nivelit më të lartë. Ndërsa DKETEZ u reagoi pozitivisht ndaj këtij koncepti, për shkak të kohës dhe kufizimeve të tjera, materialet novatore të trajnimit u limituan me Guidën e Trajnerëve dhe me disa faqe “të shkëputshme” me referenca të përmbledhura të vendosura në fund të manualit të trajnimit të KQV.<sup>8</sup>*

- Kur u pyetën nëse do të dëshironin një video trajnimi, një guidë me referenca të përmbledhura, apo materiale të tjera shtesë, dy të tretat (67%) e pëlqyen idenë e një video trajnimi dhe 43% do të kishin pëlqyer të kishin ndonjë lloj guidë me referenca të përmbledhura apo një listë me kërkesat.
- Nga diskutimet e grupeve të fokusuara, ashtu si edhe nga konstatimet nga vlerësimi i ditës së zgjedhjeve u ritheksua që guida e referencave të përmbledhura është e dobishme. Ata gjithashtu thanë që sa më shumë materiale të merrnin komisionerët, aq më mirë do të ishte. Ndërsa ideja e videos së trajnimit ishte shumë popullore në grupet e fokusuara, të intervistuarit

<sup>8</sup> Për shkak të kufizimit të hapësirës, fletët e referencave të përmbledhura nuk mund të përfshiheshin në manualin zyrtar të trajnimit në fund.

theksuan që një ndihmë e tillë duhet të përdoret *përvec* manualit dhe sesioneve të trajnimit dhe jo si një zëvendësues për trajnimin që ndodh normalisht.

- Nga lista që ju tregua, anëtarët e KQV-ve kishin më shumë interes të merrnin informacion shtesë lidhur me gjetjen e emrave të zgjedhësve në listë (31%) dhe plotësimin e proces-verbaleve në mbylljen e QV (26%). Menaxhimi i ankesave të zgjedhësve/vëzhguesve (19%) dhe hapja e qendrës së votimit (18%) u përzgjedhën gjithashtu si tema me interes.

<b><i>“Nëse mund të sygjeroni aspekte të punës tuaj që mendoni se duhet të mbuloohen më gjerë në trajnimet e ardhshme për komisionerët, cilat do të ishin ato? Hapja e qendrës së votimit, gjetja e emrit të zgjedhësve në listë, plotësimi i PV në mbylljen e qendrës së votimit, paketimi i materialeve në mbyllje të qendrës së votimit, ankesat nga zgjedhësit/vëzhguesit apo ndonjë aspekt tjetër i punës tuaj?”[LEXO TE GJITHA OBSIONET E PERGJIGJEVE, ME SHUMË SE NJË PËRGJIGJE LEJOHET]</i></b>	
<b><i>Tema</i></b>	<b><i>% e rasteve (më shumë se një përgjigje lejohet)</i></b>
<b><i>Gjetja e emrave të zgjedhësve në listë</i></b>	31%
<b><i>Plotësimi i PV të mbylljes</i></b>	26%
<b><i>Menaxhimi i ankesave të zgjedhësve/vëzhguesve</i></b>	19%
<b><i>Hapja e qendrës së votimit</i></b>	18%
<b><i>Paketimi i materialeve</i></b>	13%
<b><i>Të tjera</i></b>	5%
<b><i>Nuk mendoj që ka një çështje që duhet të trajtohet më gjerë në trajnimet e ardhshme për komisionerët e qendrave të votimit</i></b>	33%

- Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuar raportuan nevojën për më shumë informacion të specifikuar. Ata ishin kuriozë të dinin se çfarë duhet të bënin në situata të caktuara, si për shembull kur mbaronte boja ose çfarë të bëje kur njerëzit nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose janë vendosur në listë me mbiemër tjetër. Gjithashtu, shumë prej tyre nuk ishin të sigurt sesi të organizonin ambientin e brendshëm të qendrës së votimit. Manuali mbulonte disa nga sygjerimet sesi të organizohet qendra e votimit, por kur u ndodhën në Ditën e Zgjedhjeve ata nuk ishin të sigurt sesi të organizonin hapësirat specifike të qendrës së tyre të votimit. Disa raportuan që ju duhej të pastronin dhomën ku do të ndodhte votimi; të tjerë ishin konfuzë sesi të organizonin ambientin në mënyrë sa më efektive me qëllim që të ruhej sekret i votës.
- Sipas shumë pjesëmarrësve të grupeve të fokusuar, të lajmëronin për pjesëmarrjen në votime tek KZAZ-ja gjatë orëve të votimit ishte gjithashtu e vështirë. Shumë anëtarë të KQV-ve mendojnë që procesi do të funksiononte më mirë nëse komisioni zonal (KZAZ) do i merrte ata në telefon gjatë ditës për t’u informuar për pjesëmarrjen në votime, sesa ata të përpiqeshin të



telefononin apo t'i dërgonin sms KZAZ-së. Shumë pjesëmarrës të grupeve të fokusuara gjithashtu raportojnë që dorëzimi i materialeve në KZAZ në fund të Ditës së Zgjedhjes ishte problematik. Çështjet me këtë proces varionin nga mungesa e mjeteve të transportit për të transportuar materialet, deri te rradhët e gjata dhe pritjet pasi komisionerët kishin mbërritur në KZAZ, kjo për arsye të numrit të madh të KQV-ve që përpiqeshin të dorëzonin materialet e votimit në të njëjtën kohë.